



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
DREJTORIA FINANCË BUXHET,SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2655 Prot.

Përmet, më 15 . 08 2025

Lënda: Njoftim për vende të lira pune në Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Përmet

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKB NR.55 datë 02.07.2025 “Për një ndryshim në VKB NR 107 datë 18.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë, Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi të saj, i ndryshuar si dhe VKB nr 60 datë 02.07.2025 “Për një ndryshim në VKB Nr.109 datë 18.12.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve dhe të personave të zgjedhur dhe të emëruar të Bashkisë Përmet dhe të institucioneve që varen prej saj për vitin 2025”, Bashkia Përmet njofton se shpallen 3 (tre) vende të lira pune në pozicionet Kryeinspektor dhe Inspektor i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Përmet

1(një) Kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Përmet

2 (dy) Inspektor i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Përmet

KREU I- Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës

Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, pranë Bashkisë Përmet ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit nga ndërtimet e kundërligjshme dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera. Kryeinspektori dhe Inspektoret do të kryejë punën pranë punëdhënësit, në vendin e punës pranë Bashkisë Përmet.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Verifikon përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.
- Plotëson proces-verbalin e konstatimit dhe relacionin/mendimin sipas rastit dhe dispozitave ligjore në fuqi në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.
- Punon në vijimësi për përditësimin e informacionit mbi situatën ndërtimore si dhe njohjen e detajuar të kësaj situatë në shtrirjen gjeografike të territorit që mbulon.
- Zbaton me përpikmëri grafikët dhe planet e punës së miratuar.
- Përgjigjet drejtpërdrejt për zbatimin e ligjshmërisë dhe respektimin e etikës zyrtare dhe korrektesës në marrdhënie me subjektet që i nënshtrohen procedurave të kontrollit dhe inspektimit.

- Përgjigjet drejtpërdrejt për zbatimin e ligjshmerisë, evidentimin dhe plotësimin korrekt të formularëve standart që dokumentojnë ushtrimin e përgjegjësive procedurale të kontrollit dhe inspektimit.
- Ndjek problematikën e paraqitur në shkresat dhe kërkesë-ankesat, informon me shkrim për problematikat e dala dhe jep mendim për zgjidhjen e tyre.
- Paraqet relacionin për çdo procedure të mbajtur gjatë inspektimit.
- Të hartojë akt ekspertimin e punimeve ndërtimore të paligjshme sipas procesverbaleve të konstatimit dhe në bazë të kësaj të përcaktohet vlera e këtyre punimeve që është e barasvlefshme me atë të dënimit me gjobë.
- Të kontrollojë zbatueshmërinë e lejeve të ndërtimit si specialist i fushës si pjesë e grupit të punës në IMT.
- Të japë mendimin e tij profesional – teknik në fushën e ndërtimit dhe është pjesë e plan veprimit të IMT-së për ekzekutimin e vendimeve të prishjeve sipas rasteve të nevojshme

KREU II – Kërkesa të përgjithshme për pranimin:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të ketë përfunduar arsimin e lartë në fushat e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruktit, transportit, tekno-logjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit, jurist, niveli minimal i diplomës Master Shkencor për Kryeinspektorin, Master Profesional për Inspektoret
- Preferohet të ketë eksperiencë pune, në fushën e ndërtimit;
- Të ketë aftësi për të zbatuar përgjegjësitë dhe realizimin e objektivave të institucionit;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna.

KREU III-Dorëzimi i dokumenteve

Kandidati duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar pranë Zyrës së protokollit të Bashkisë Përmet deri në datën **29.08.2025, ora 12:00**.

1. Kërkesë me shkrim drejtuar institucionit të Bashkisë Përmet;
2. Fotokopje e ID (kartë identiteti);
3. Jetëshkrim (CV);
4. Çertifikatë personale
5. Çertifikatë familjare;
6. Diplomë dhe listë notash të noterizuara
7. Raport mjeko-ligjor për aftësi në punë;
8. Referencë me karakteristika specifike nga punëdhënësi i fundit (në rast punësimi të mëparshëm)
9. Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi (në rast punësimi të mëparshëm)
10. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë

11. Vërtetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë
12. Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti)
13. Fotokopje të librezës së punës (nëse ka) ;
14. Çertifikata, trajnime profesionale, në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, edukimit dhe në fushën e aftësisë së kufizuar (nëse ka);

Dokumentacioni i mësipërm të shoqërohet me listën e inventarizuar të dokumentacionit të dorëzuar, e nënshkruar nga kandidati Brenda datës **29.08.2025, ora 12:00.**

Mungesa e njërit prej dokumenteve të mësipërme apo pavlefshmëria e dokumenteve sjell skualifikimin e konkurrentit.

Pas verifikimit paraprak të dokumentacionit, kandidatët e kualifikuar, në lidhje me dokumentacionin e paraqitur do të njoftohen nëpërmjet adresës elektronike, do të shpallet lista e konkurrenteve që do të plotësojnë kriteret, si dhe data kur do të zhvillohet intervista me gojë.

Kreu IV – Mënyra e vlerësimit do të jetë:

Vlerësimi i dokumentacionit 40 pikë

Vlerësimi i intervistës me gojë 60 pikë

Në përfundim të procedurës së vlerësimit, kandidati që merr mbi 70 pikë në total do të shpallet kandidat i kualifikuar për plotësimin e vendit të lirë.

Konkurimi do të bazohet në njohuri të përgjithshme mbi legjislacionin e fushës së ndërtimit; Ligji nr 9780/2007, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar;

Ligji nr.8402/1998, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar;

Ligji nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar;

Ligji nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe intergrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

VKM nr.408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit ”, i ndryshuar;

VKM nr.894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njesisë Vendore”.

VKM nr.610, datë 22.09.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.

Udhëzim i KM nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

Udhëzim i KM nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

